



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.41

20 prill

2011

P Ë R M B A J T J A

| | Faqe |
|--|---|
| Ligj nr.10 400 datë 24.3.2011 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Shoqëria Rajonale “Korça”, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë” 1757 |
| Vendim i Kuvendit nr.91, datë 24.3.2011 | Për caktimin e fondeve publike që do t’u shpërndahen subjekteve zgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2011..... 1790 |
| Vendim i Kuvendit nr.92, datë 24.3.2011 | Për zgjedhjen e kryetarit të komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e drejtimit dhe veprimtarisë së organeve drejtuese dhe shërbimeve të Kuvendit për periudhën shtator 2005-dhjetor 2010 ngritur me vendimin nr.90, datë 17.3.2011 1790 |
| Vendim i KM nr.215, datë 23.2.2011 | Për miratimin e raportit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri, për vitin 2009 1791 |
| Vendim i KM nr.260, datë 6.4.2011 | Për një shtesë në vendimin nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar 1791 |
| Urdhër i MB nr.140, datë 13.4.2011 | Për delegimin e kompetencës, për miratimin e shërbimeve në largësi mbi 100 km, jashtë qendrës së punës, të punonjësve të institucionit të Prefektit 1792 |

LIGJ
Nr. 10 400, datë 24.3.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE DHE SHOQËRIA RAJONALE “KORÇA”, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“ADMINISTRIMI I MBETJEVE TË NGURTA NË JUGLINDJE TË SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Shoqëria Rajonale “Korça”, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Administrimi i mbetjeve të ngurta në juglindje të Shqipërisë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6964, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIMI DHE PROJEKTI
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (PËRFITUESI) DHE SHRMMK,
SHOQATËS RAJONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE, KORÇË (AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 2,000,000.00 EURO

- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore (2008 65 170)

Mbi bazën e një marrëveshjeje që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, mbi bashkëpunimin financiar (marrëveshja qeveritare), përfituesi, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja nënshkruajnë Marrëveshjen e mëposhtme të financimit dhe projektit.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i ofron përfituesit një kontribut financiar jo më pak se 2,000,000.00 euro.

Ky kontribut financiar nuk është i kompensueshëm, nëse nuk përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Përfituesi i ofron kontributin financiar të plotë agjencisë së zbatimit të projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit përdor kontributin financiar vetëm për financimin e fazës së parë të zbatimit të projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore” (projekti), dhe kryesisht për të paguar kostot e shkëmbimit të huaj.

Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e projektit dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar nga një marrëveshje e veçantë, e cila duhet të bihet dakord nga përfituesi dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike, që duhet të përballohen nga përfituesi, agjencia e zbatimit të projektit ose konsulenti (duke përfshirë mbajtjen e taksës) dhe taksat e importit, nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Ofrimi i kontributit financiar për agjencinë e zbatimit të projektit

2.1 Përfituesi i ofron kontributin financiar agjencisë së zbatimit të projektit si grant të pashlyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, përfituesi do t'i japë KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së përmendur në nenin 2.1.

2.3 Ofrimi i kontributit financiar nuk përbën përgjegjësi të agjencisë së zbatimit të projektit për KfW-në për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja disburson kontributin financiar në përputhje me ecurinë e projektit dhe me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit. Me një marrëveshje të veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti të dhënat që provojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimet e caktuara. Marrëveshja e veçantë duhet të bihet dakord nga përfituesi dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë për të bërë disbursime pas datës 31.12.2013.

Neni 4

Pezullimi i disbursimit dhe shlyerjes

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet përveç nëse:

a) përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të bërë pagesa, kur ato bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose marrëveshjeve të veçanta në lidhje me këtë marrëveshje, nuk janë shkelur;

c) agjencia e zbatimit të projektit nuk është e aftë të provojë se kontributi financiar është përdorur për qëllimin e caktuar; ose

d) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

4.2 Nëse ka ndodhur ndonjë prej situatave të përcaktuara në nenin 4.1 (b) ose (c) dhe nuk është zgjidhur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që, gjithsesi, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 (b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 (c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të këtyre shumave kur agjencia e zbatimit të projektit nuk është e aftë të provojë se ato janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi përballon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me nënshkrimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që shkaktohen në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe personat e caktuar nga ai/ajo në KfW dhe të autorizuar nga modele nënshkrimesh të vërtetuara nga ai/ajo, përfaqësojnë përfituesin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Administratori i përgjithshëm i SHRMMK-së dhe personat e caktuar nga ai/ajo në KfW dhe të autorizuar nga modele nënshkrimesh të vërtetuara nga ai/ajo, përfaqësojnë agjencinë e zbatimit të projektit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Prokurat nuk do të skadojnë deri në anulimin e tyre përfundimtar nga përfaqësuesi i autorizuar në kohën që janë marrë nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat në këtë marrëveshje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë do të jetë marrë nëse është dërguar në adresën e mëposhtme të autoritetit kontraktues përkatës ose në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i njoftohet palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW
L III a/4
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Faks: +49 69 7431-2944

Për përfituesin: Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit, nr. 1
Tirana, Republika e Shqipërisë
Faks: +355 42 22 8494

Për agjencinë e zbatimit të projektit: SHRMMK
Rr. "Konferenca e Pezës"
Ish-shkolla "Th. Kavalioti" kati II, Korçë
Republika e Shqipërisë
Tel/Faks: +355 822 481 86

6.3 Ndryshimet e kësaj marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe përfituesit nuk kërkojnë aprovimin e agjencisë së zbatimit të projektit.

Neni 7

Projekti

7.1 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe mirëmban projektin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe kryesisht në përputhje me konceptimin e projektit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit për inxhinierët konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e projektit për firmat e kualifikuara;

c) lidh kontrata për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar pas ofertimit konkurrues paraprak ndërkombëtar;

d) mban ose kujdeset drejtpërdrejt për mbajtjen e librave dhe regjistrave që deklarojnë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

e) i mundëson në çdo kohë përfaqësuesve të KfW-së të inspektojnë librat dhe regjistrat e lartpërmendur dhe secilin, dhe të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e projektit, dhe të vizitojnë projektin dhe të gjitha njësitë e lidhura me të; dhe

f) i jep KfW-së secilin dhe të gjithë këtë informacion dhe regjistra për projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme që mund të kërkojë KfW-ja.

7.2 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcaktojnë detajet në lidhje me nenin 7.1 me anë të një marrëveshjeje të veçantë që duhet të bihet dakord nga përfituesi dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

7.3 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) garantojnë financimin e plotë të projektit dhe sipas kërkesës, i japin KfW-së të dhëna që provojnë se kostot e papaguara nga ky kontribut financiar janë mbuluar; dhe

b) me pëlqimin e tyre, informojnë menjëherë KfW-në për secilën dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit.

7.4 Përfituesi i përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit ndihmon agjencinë e zbatimit të projektit, në përputhje me praktikatat e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare, për zbatimin e projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit sipas kësaj marrëveshjeje dhe në veçanti i jep agjencisë së zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

7.5 Për transportin e mallrave që duhet të financohen nga kontributi financiar, zbatohen dispozitat e marrëveshjes qeveritare, të cilat i njoftohen përfituesit.

Neni 8 Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit garantojnë që personat përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e projektit, lidhjen e kontratave për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen dhe kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar, të mos kërkojnë, pretendojnë, japin, dhurojnë, premtojnë ose t'u premtohen pagesa të paligjshme ose përfitime të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit vënë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me përfituesin dhe agjencinë e zbatimit të projektit, e cila është e nevojshme për këtë qëllim.

8.3 Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara për shkak të kësaj. Çdo boshllëk që rezulton nga kjo plotësohet nga një dispozitë e pajtueshme me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Përfituesi dhe agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të caktojë ose transferojë, lërë peng ose hipotekë për ndonjë pretendim nga kjo marrëveshje.

8.5 Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përmbushjes do të jetë Frankfurt mbi Main.

8.6 Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo marrëveshje ndërmjet KfW-së, përfituesit dhe agjencisë së zbatimit të projektit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes funksionale të projektit, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

8.7 Kjo marrëveshje financimi dhe projekti nuk do të hyjë në fuqi derisa marrëveshja qeveritare në të cilën është bazuar, të ketë hyrë në fuqi.

Bërë në 3 origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, Tiranë,
më , 2010
KfW
Korçë,
më , 2010
SHRMMK

Tiranë
më , 2010
Ministria e Financave

Shoqata Rajonale e Menaxhimit të Mbetjeve,
Korçë (SHRMMK)
Rr. "Konferenca e Pezës"
Ish-shkolla "Th. Kavalioti" kati II
Korçë
Republika e Shqipërisë

Adelheid Knäble de Revollo
Ref jonë: Knä
Tel: +49 69 7431-4448
email: Adelheid.Knaeble_de_Revollo@kfw.de
Datë

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Sheshi Skënderbej, NR.S
Tiranë, Republika e Shqipërisë

LIII a/4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë
Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore
2 milionë euro
BMZ-nr. 2008 65 170
Marrëveshja e veçantë e marrëveshjes së financimit dhe projektit e datës @

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Në pajtim me marrëveshjen e financimit dhe projektit, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Përfituesi), SHRMMK-ja (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW-ja (KfW) e datës @ , sa më poshtë, përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Sipas nenit 1.2:

Informacionet e hollësishme të projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar.

Sipas nenit 3.1:

Procedura e disbursimit, në veçanti, të dhënat që provojnë se shumata e kontributit financiar të disbursuar përdoren për qëllimin e caktuar.

Sipas nenit 7.2

Informacionet e hollësishme në lidhje me nenin 7.1 (zbatimi i projektit).

Ne propozojmë që të bihet dakord sa më poshtë:

I. Planprojekti

1. Informacion i hollësishëm mbi projektin

Projekti ka lidhje me fazën e parë nga dy fazat e zbatimit të projektit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore. Qëllimi i të gjithë projektit është zbatimi i një sistemi të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në rajonin e Korçës, që mbron burimet natyrore dhe mjedisin, si dhe shëndetin e njerëzve. Ky duhet të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit publik, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe shmangien e ndotjes mjedisore. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit, si dhe kushtet kryesore për arritjen e qëllimit dhe rezultateve të projektit përmbahen në aneksin 1.

Planprojekti bazohet në dokumentet e fazës tranzitore, të disponueshme për KfW-në, përfituesin dhe agjencinë e zbatimit të projektit, në marrëveshjet e bëra ndërmjet KfW-së, agjencisë së zbatimit të projektit dhe bashkive të Pogradecit, Korçës dhe Maliqit gjatë vlerësimit lokal të projektit (procesverbali i mbledhjes së datës 16 shtator 2009) dhe marrëveshjet e bëra ndërmjet KfW-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (shkresa e sigluar e datës 2 dhjetor 2009).

Aktivitetet e mëposhtme të projektit të fazës së parë të zbatimit të projektit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore do të financohen nga kontributi financiar: zbatimi i masave të menjëhershme, për shembull masat e investimit në nivel më të ulët synojnë përmirësime të dukshme të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, që përfshijnë:

- Përmirësimin e grumbullimit të mbetjeve dhe transportimin në zonat rurale dhe urbane, kur ekziston një nevojë urgjente për masat përmirësuese;

- Përmirësimin e shërbimeve aktuale të eliminimit të mbetjeve. Meqë vendgroposja e re higjienike nuk do të jetë gati para vitit 2012, duhet të vazhdojnë operacionet ekzistuese të venddepozitimit;

- Shërbimet e konsulencës për konsulentin e zbatimit të fazës së dytë të projektit.

Investimet e nevojshme të parashikuara për këto masa përmbledhen në përshkrimin e përgjithshëm mbi investimet në aneksin 2. Konsulenti në detyrë mbështet SHRMMK-në për përgatitjen dhe zbatimin e këtyre masave investimi.

2. Grafiku kohor

Grafiku kohor për përgatitjen, zbatimin dhe funksionimin e projektit përmbahet në aneksin 3.

3. Kostoja totale dhe financimi

Kostoja totale e llogaritur e projektit (kostoja totale) që përbën vlerësimin e projektit është rreth 2 milionë euro. Shuma e kontributit financiar është 2 milionë euro. Elementet e kostove totale dhe planit të financimit përmbahen në aneksin 4.

4. Ndryshimet në planprojekt

Çdo ndryshim kryesor në planprojekt kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Agjencia e zbatimit të projektit do të informojë menjëherë për këtë KfW-në, duke deklaruar arsyet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (përfshirë për koston totale). Zbatimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me miratimin e KfW-së.

II. Zbatimi i projektit

1. Përgjegjësitë dhe grafiku kohor i kostos dhe i financimit

1.1 SHRMMK-ja është përgjegjëse për zbatimin dhe funksionimin e projektit.

1.2 Grafiku i detajuar kohor, i kostos dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të projektit, do të përgatitet sa më shpejt që të jetë e mundur nga agjencia e zbatimit të projektit, në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shuma, ndërlidhjen e synuar kronologjike të aktiviteteve të projektit dhe kërkesat rezultuese financiare. Nëse ndonjë devijim nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të projektit, KfW-së do t'i sigurohet një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Detyrat e konsulentit të ardhshëm (konsulenti i zbatimit) për fazën e dytë të investimit do të përfshijnë përgatitjen e planprojektit të detajuar për punimet e ndërtimit të vendgroposjes që duhet të zhvillohen gjatë fazës së dytë të zbatimit, si bazë për dokumentet e tenderit, si dhe përgatitjen e specifikimit për blerjen e pajisjeve të lëvizshme dhe pajisjeve të tjera. Ky konsulent do të realizojë edhe punimet e mbikëqyrjes së ndërtimit.

2.2 Pas përzgjedhjes paraprake dhe ofertimit konkurrues ndërkombëtar, kontrata do të lidhet me një konsulent të kualifikuar të pavarur. Procedura e lidhjes së kontratës rregullohet nga "Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 5) që formon pjesë përbërëse të saj.

2.3 Në njoftimin e parakualifikimit ose, nëse nuk është kryer asnjë parakualifikim, në ftesën për tendera, agjencia e zbatimit të projektit do të detyrojë ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e ofertimit ose së bashku me ofertën, një deklaratë sipërmarrjeje të nënshkruar rregullisht (aneksi 5, faqe 16).

3. Lidhja e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për mallra dhe të gjitha shërbimet e tjera përgatiten dhe jepen në bashkëpunim me konsulentin në detyrë për fazën e parë të zbatimit, me anë të ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për komente në kohën e duhur, para publikimit të ftesës për tender.

3.3 Periudha e ofertimit caktohet në një mënyrë, që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Informacionet e tjera të hollësishme mbi procedurën e lidhjes së kontratës dhe dispozitat kontraktuale shpjegohen në “Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 6) që formon pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin e parakualifikimit ose nëse nuk është kryer asnjë parakualifikim, në dokumentet e tenderit, agjencia e zbatimit të projektit do të detyrojë ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën, një deklaratë sipërmarrjeje (aneksi 6, faqe 27).

3.6 Në lidhjen e kontratave për mallra dhe shërbime që duhet të financohen nga kontributi financiar, agjencia e zbatimit të projektit respekton parimet e mëposhtme:

a) Ndërsa asnjë taksë importi nuk mund të financohet nga kontributi financiar sipas nenit 1.3 të marrëveshjes së financimit dhe projektit, këto taksa importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, do të deklarohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet, dhe në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme sipas kontratave për mallra dhe shërbime duhet të bëhen nga kontributi financiar, kontratat e lartpërmendura do të përfshijnë një klauzolë që përcakton se çdo rimbursim, garanci ose pagesa të ngjashme të kërkueshme dhe çdo pagesë sigurimi do të bëhet për llogari të agjencisë së zbatimit të projektit në llogarinë nr.38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) në KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), me KfW-në që krediton këto pagesa në llogarinë e përfuturit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën vendase, ato do të bëhen në një llogari të veçantë të agjencisë së zbatimit të projektit në vendin e agjencisë së zbatimit të projektit, që mund të tërhiqen vetëm me miratimin e KfW-së. Këto fonde mund të ripërdoren për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së një kontrate për mallrat dhe shërbimet, KfW-së do t'i jepen komente me projektkontratën e rënë dakord, të siguruar me vizën e konsulentëve. Kjo zbatohet për çdo marrëveshje të mëtejshme ndryshuese ose modifikuese.

4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 Para tenderimit të shërbimeve të konsulencës së zbatimit në fazën 2, procesi i miratimit të vlerësimit të ndikimit mjedisor do të ketë filluar dhe do të jetë në proces të konsultimit publik.

5. Kushtet për funksionimin e duhur të projektit

Për të siguruar funksionimin e duhur të projektit (faza e parë e zbatimit), agjencia e zbatimit të projektit do të paraqesë një koncept operacional dhe mirëmbajtjeje për shërbime të ndryshme SWM (me përjashtim të vendgroposjes së re që duhet të vendoset gjatë fazës së dytë të zbatimit), të hartuar në bashkëpunim me konsulentin së paku para përfundimit të caktimit të konsulentit në detyrë për fazën e parë të zbatimit.

Njëkohësisht, agjencia e zbatimit të projektit do t'i paraqesë KfW-së një parashikim financiar të përgatitur në bashkëpunim me konsulentin, për fushën e operimit në të cilën është vendosur projekti. Ky parashikim duhet të deklarojë shpenzimet e bëra në kuadrin e projektit (faza e parë dhe e dytë e zbatimit) dhe fitimet e pritshme për këtë fushë të caktuar operimi në kohën që ato ndodhin. Agjencia e zbatimit të projektit përditëson periodikisht këtë parashikim dhe garanton që çdo boshllëk financiar të mbulohet në kohën e duhur. Agjencia e zbatimit të projektit ia transmeton pa vonesë KfW-së këtë parashikim financiar dhe versionet e tij të rishikuara.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve, dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen nga kontributi financiar përgatitet mbi bazën e kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Rrjedhimisht, KfW-së do t'i jepet një origjinal ose kopje e secilës prej kontratave të lartpërmendura dhe të çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse ndonjë masë projekti duhet të realizohet për punimet e kontraktuara të ndërtimit dhe nuk është lidhur asnjë kontratë, KfW-ja do të marrë në vend të kontratave një skedul të masave të planifikuara, të zbrërthyer në bazë të kategorive kryesore të kostos (skeduli i masave për punimet e kontraktuara të ndërtimit). Kostot e shkaktuara për administrimin e përgjithshëm në lidhje me

punimet e kontraktuara të ndërtimit nuk duhet të përfshihen në skedulin e lartpërmendur të masave mbi punimet e kontraktuara të ndërtimit.

1.3 KfW informon, me kërkesë, agjencinë e zbatimit të projektit, për shumat e kontributit financiar që ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret e përcaktuara në aneksin nr.7 (procedura e disbursimit), që formojnë pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje.

IV. Raportimi dhe klauzola të tjera

1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të mëtejshëm, agjencia e zbatimit të projektit do t'i raportojë KfW-së çdo tre muaj progresin e projektit (raportet e progresit), duke përfshirë përmbushjen e marrëveshjes së zbatimit të përcaktuar në seksionin II.4 të kësaj marrëveshjeje dhe zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera kryesore të përgjithshme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 8. Për më tepër, agjencia e zbatimit të projektit do të raportojë në lidhje me të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivit të përgjithshëm, qëllimin dhe rezultatet e projektit. Në kohën e përfundimit fizik dhe vënies në funksionim të projektit, por para maksimumit të skadimit të periudhës së garancisë, agjencia e zbatimit të projektit do të paraqesë një raport përfundimtar në lidhje me masat e realizuara. Raporti i parë mbi gjendjen aktuale (raporti fillestar) u paraqit më 30 qershor 2010. Raportet duhet të jenë marrë nga KfW-ja, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave jo më vonë se 2 javë pas përfundimit të periudhës nën rishikim. Raportet do të siglohen nga konsulenti për periudhën e caktimit të konsulentit.

1.2 Nëse agjencia e zbatimit të projektit ka ngarkuar konsulentin të hartojë raportet e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, agjencia e zbatimit të projektit do të komentojë në lidhje me raportet ose do të konfirmojë pëlqimin e saj për përmbajtjen me anë të siglimit të raporteve përkatëse.

1.3 Pas përfundimit të projektit, agjencia e zbatimit të projektit do të raportojë zhvillimin e tij të mëtejshëm (shihni aneksin 8 për informacione të hollësishme). KfW-ja do të informojë agjencinë e zbatimit të projektit në kohën e duhur në lidhje me përfundimin e periudhës së raportimit.

2. Klauzola të tjera

2.1 Agjencia e zbatimit të projektit i dërgon KfW-së të gjitha dokumentet e nevojshme për KfW-në për të dhënë komente dhe aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura, brenda një kohe të shpejtë për të lejuar kohë të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Agjencia e zbatimit të projektit krijon afishe të projektit që përmbajnë minimalisht mesazhin e mëposhtëm:

“Një projekt zhvillimi i Republikës së Shqipërisë, i zbatuar nga SHRMMK-ja, i bashkëfinancuar nga Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së”.

Një vulë projekti e dhënë nga ambasada gjermane vendoset në afishen e projektit.

2.3 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me pëlqim të ndërsjellë, nëse kjo është e vlefshme për zbatimin e projektit ose zbatimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit. Në të gjitha drejtimit e tjera, dispozitat e nëneve 6.2 dhe 8 të marrëveshjes së financimit zbatohen për këtë marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme, duke nënshkruar në formë ligjërishit detyruese dhe duke kthyer kopjet e bashkëlidhura.

Ju lutem i përcillni në kohën e duhur një kopje të kësaj shkrese konsulentit në detyrë.

Me respekt,
KfW

ANEKSET

Aneksi 1: Objektivat dhe rezultatet e projektit dhe kushtet për arritjen e tyre
(LogFrame)

Aneksi 2: Informacion i përgjithshëm mbi investimet

Aneksi 3: Grafiku kohor

Aneksi 4: Kostoja totale dhe financimi

Aneksi 5: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 6: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 7: Procedura e disbursimit

Aneksi 8: Përmbajtja dhe forma e raportimit


Lexuar dhe rënë dakord:

Ministria e Financave

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

SHRMMK

ANEKSI 1
QASJA E KUADRIT LOGJIK - MENAXHIMI I MBETJEVE PËR SHQIPËRINË JUGLINDORE



ANEKSI 2
INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI INVESTIMET

| Faza e parë e zbatimit 2010 | Përshkrimi i masave të mundshme | Totali |
|---|---|------------------|
| Masa të menjëhershme | | |
| Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese të eliminimit | Përmirësimi i funksionimit të 4 venddepozitimeve kryesore (Korça, Pogradeci etj.) duke përfshirë qiranë e pajisjeve, formën e zonës së mbetjeve (planprojekti dhe dokumentet e tenderit të bëra nga SHRMMK-ja me mbështetjen e konsulentit në detyrë) | 400,000 |
| Zgjerimi me thasë i grumbullimit rural | P.sh. prokurimi i 4 kamionëve horizont, duke përfshirë pjesët e këmbimit (planprojekti dhe dokumentet e tenderit të përgatitura nga SHRMMK-ja me mbështetjen e konsulentit në detyrë) | 120,000 |
| Implementimi i grumbullimeve rurale me kamionë ngarkim-shkarkimi | P.sh. prokurimi i 2 kamionëve ngarkim shkarkim, plus 40 mjete të ngjashme (planprojekti dhe dokumentet e tenderit të bëra nga SHRMMK-ja me mbështetjen e konsulentit në detyrë) | 200,000 |
| Përmirësimi i mbledhjeve urbane | P.sh. prokurimi i 400 1.1 m ³ kontejnerë, 100 vende kontejnerësh të ndërtuara kohët e fundit (planprojekti dhe dokumentet e tenderit të bëra nga SHRMMK-ja me mbështetjen e konsulentit në detyrë) | 380,000 |
| Konsulenti i zbatimit (dokumentet e tenderit, ndërtimit, mbikëqyrjes) | | 700,000 |
| Të ndryshme dhe të paparashikuara | Rritja e ndërgjegjësimit/marrëdhëniet me publikun Identiteti i korporatës | 200,000 |
| Faza e parë e zbatimit për shumën e investimit 2010 | | 2,000,000 |

ANEKSI 4
KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

| Kostoja totale dhe financimi | | |
|--|-----------------------|-----------------------------------|
| Faza e parë e zbatimit, 2010 | Kostoja (në €) | Financimi (në € granti FC) |
| Masa të menjëhershme | | |
| Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese të eliminimit të hedhjeve | 400,000 | 400,000 |
| Zgjerimi me thasë i mbledhjeve rurale | 120,000 | 120,000 |
| Implementimi në lidhje me kamionët e ngarkim-shkarkimit për grumbullimin rural | 200,000 | 200,000 |
| Përmirësimi i grumbullimeve urbane | 380,000 | 380,000 |
| Konsulenti i zbatimit (dokumentet e tenderit, ndërtimi, mbikëqyrja) | 700,000 | 700,000 |
| Të ndryshme dhe të paparashikuara | 200,000 | 200,000 |
| Shuma e investimit për fazën e parë të zbatimit, 2010 | 2,000,000 | 2,000,000 |

ANEKSI 5
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME
VENDET NË ZHVILLIM

[http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service und Dokumentation/Online Bibliothek/PDF-Dokumente Richtlinien/Consultingrichtlinie E 11 200615701.pdf](http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf)

ANEKSI 6
UDHËZIME PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNIMEVE SIPAS
BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

[http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service und Dokumentation/Online Bibliothek/PDF-Dokumente Richtlinien/Vergaberichtlinie E 05 2007.pdf](http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Vergaberichtlinie_E_05_2007.pdf)

ANEKSI 7 I MARRËVESHJES SË VEÇANTË

Zyrtari përgjegjës: Caroline Möllern
tel: +49 69 7431-3542
email: caroline.moeller@KfW.de

Procedura e disbursimit

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së

2 milionë euro

Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore

Referenca e KfW-së nr. 2008 65 170, faza 1

1. Hyrje

Ky aneks përcakton procedurën e disbursimit për projektin/programin e lartpërmendur. Marrëveshja e veçantë, duke përfshirë këtë aneks, i vihet në dispozicion të gjithë personelit të huamarrësit, përfituesit ose agjencisë së zbatimit të projektit/programit (pala e autorizuar) dhe çdo pale tjetër të përfshirë në disbursime.

KfW-ja disburson huat dhe kontributet financiare të pakthyeshme (fondet), me kërkesën e palës së autorizuar, në përputhje me ecurinë e projektit/programit të financuar. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallrat dhe shërbimet specifike mbi bazën e “Marrëveshjes së veçantë” në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/projektit/programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet korresponduese të rezervuara formojnë kështu kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursim nga KfW-ja pas plotësimit të të gjitha kushteve kontraktuale për disbursim.

2. Dispozita të përgjithshme

2.1 Të gjitha kërkesat për tërheqje:

- tregojnë numrin e referencës së KfW-së;

- numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme; dhe

- firmosen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që është caktuar si i autorizuar ndaj KfW-së dhe të cilit KfW-ja i ka marrë modele nënshkrimesh (shembull, shihni shtojcën A).

2.2 Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat origjinale të tërheqjes. Nëse në raste të veçanta një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë pas shënimit si konfirmim faksi. Pala e autorizuar e liron KfW-në nga përgjegjësia për dëme që shkaktohen nga transmetime të rreme, në veçanti për shkak të transmetimeve të gabuara, abuzimit, keqkuptimit ose gabimeve.

2.3 Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga monedha e angazhuar (valuta e huaj), KfW-ja do t'i debitojë huamarrësit ose përfituesit këtë shumë që është shpenzuar nga KfW-ja për blerjen e valutës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e paparashikuara.

2.4 KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transferuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse vonesat shkaktohen nga KfW-ja, përgjegjësia e saj do të kufizohet në pagesën e interesit të lindur.

3. Dispozita të veçanta

3.1 Pala e autorizuar është Shoqata e Menaxhimit të Mbetjeve të Rajonit të Korçës (SHRMMK).

3.2 Procedura duhet të zbatohet

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. +

I.3

1.3 Konsultimi diskutohet sipas procedurës së drejtpërdrejtë të disbursimit.

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3. Masat e investimit disbursohen sipas procedurës së fondit rezervë (llogaria e veçantë). Kontrata/masat specifike që duhet të financohen nga fondi rezervë nuk tejkalojnë shumën prej 350,000 euro ose ndonjë shumë të barasvlershme. Të gjitha kontratat/masat specifike që duhet të financohen, të cilat nuk tejkalojnë shumën prej 350.000,00 euro ose ndonjë shumë të barasvlershme, disbursohen sipas procedurës së drejtpërdrejtë të thjeshtuar të disbursimit.

3.3 Procedura e drejtpërdrejtë e disbursimit (konsulenti)

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (shihni shtojcën D) me emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (informacione të plota bankare).

3.3.1 Dokumentet që mbështesin kërkesën për tërheqje, kurdoherë që është e zbatueshme:

- Kopje e faturës së konsulentit.

- Të dhëna mbi bazat e rëna dakord nga pikëpamja kontraktuale për llogaritjen e çmimit në rast të ngritjes së çmimit.

- Lista e shpenzimeve për kostot e rimbursueshme me datën, përshkrimin, çmimin, kursin e këmbimit të shpenzimeve, të nënshkruara rregullisht nga konsulenti, që deklarojnë se informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

3.3.2 Dokumentet

Të gjitha të dhënat dokumentuese origjinale të shpenzimeve, që i korrespondojnë faturave duhet të ruhen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave financiare dhe do të duhet të jenë të aksesueshme në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palë të treta të informuara për këtë nga KfW-ja (për shembull, audituesit) ose do t'i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja.

3.4 Operimi i fondit rezervë (llogaria/të e veçantë/a)

Për qëllim të fondit rezervë, do të hapet një llogari e veçantë në emër të konsulentit si llogari besimi. Informacione të hollësishme përmbahen në pikën 1 të kushteve plotësuese të bashkëlidhura të KfW-së për pagesa, sipas procedurës së fondit rezervë “kushtet plotësuese” (shtojca B). Elementet e nevojshme për disbursime përcaktohen në pikën 2 të “kushteve plotësuese”.

Llogaria duhet të mbahet në euro dhe me normë interesi. Në rast se do të jetë më efektive bërja e pagesave lokale nga një llogari lokale, kjo llogari do të mbahet më tej si llogari e veçantë lokale. Për të shmangur humbjet në zhvlerësimin e monedhës, vetëm shpenzimet e planifikuara për një periudhë njëmuore të nevojshme lejohen të transferohen nga llogaria e mësipërme e veçantë në llogarinë e veçantë lokale në valutë.

3.4.1 Pala e autorizuar informon KfW-në që të paguajë një depozitë fillestare (parapagim) në llogarinë që zotëron pala e miratuar, deri në një shumë që mbulon shpenzimet për një periudhë katërmujore. Shuma aktuale që duhet të disbursohet i nënshtrohet paraqitjes së një parashikimi nga pala e tretë e autorizuar (konsulenti) të shpenzimeve të planifikuara për katër muajt e ardhshëm. Për plotësim të llogarisë së veçantë, pala e autorizuar (e sigluar nga pala e tretë e autorizuar) do të paraqesë të dhëna dokumentuese, së bashku me kërkesën për plotësim pasi shpenzimet prej të paktën 50% të depozitës fillestare të mund të argumentohen (kërkesa për plotësim, shihni modelin në shtojcën B/aneksi 3 “kushtet plotësuese”). Shuma që duhet të plotësohet i nënshtrohet paraqitjes së një parashikimi të ri të shpenzimeve për katër muajt e ardhshëm.

Në çdo rast, të dhënat dokumentuese të përdorimit të fondeve duhet të paraqiten, maksimumi katër muaj pas pagesës pararendëse, pavarësisht nëse shuma e lartpërmendur minimale e shpenzimeve është plotësuar. Nëse ky afat nuk mund të respektohet, KfW-ja do të informohet menjëherë për gjendjen aktuale (shihni pikën 8 “Kushtet plotësuese”).

Në rast se shuma për të cilën janë siguruar të dhëna dokumentuese të përdorimit të fondeve nuk do të jetë e mjaftueshme për plotësim ose nuk kërkohet asnjë plotësim, kjo shumë do të kompensohet kundrejt shumës së depozitës fillestare.

3.5 Pala e autorizuar cakton një auditues të jashtëm për të shqyrtuar çdo vit (në përputhje me termat e referencës së KfW-së për audituesit, shtojca C) nëse fondi rezervë është administruar siç duhet. Auditit përfundimtar do të kryhet gjashtë muaj pas disbursimit të fundit nga llogaria e veçantë.

Një kopje e çdo raporti audituesi do t'i dërgohet KfW-së në kohën e duhur pas përfundimit të periudhës nën rishikim.

3.6 Në rast devijimesh midis kushteve plotësuese dhe “dispozitave të veçanta”, këto të fundit do të jenë të vlefshme.

3.7 Procedura e drejtpërdrejtë e thjeshtuar e disbursimit

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë për tërheqje të nënshkruar rregullisht, të vërtetuar nga konsulenti (shihni shtojcën E) me emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (informacione të plota bankare) dhe do të bashkëlidhë një kopje të faturës së kontraktuesit.

KfW-ja disburson fonde për llogari të palës së autorizuar drejtpërdrejt te kontraktuesit e mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen nga KfW-ja.

Siç është rënë dakord në kontratën e konsulencës, konsulenti do t'i japë palës së autorizuar një “vërtetim pagese” që konfirmon se të gjitha elementet e nevojshme për disbursim janë përmbushur dhe se të gjitha dokumentet e paraqitura (duke përfshirë garancitë) janë në përputhje me kushtet e kontratës dhe rregullat/standardet e KfW-së.

3.7.1 Dokumentet

Të gjitha të dhënat dokumentuese origjinale të shpenzimeve që i korrespondojnë faturave duhet të ruhen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe do të duhet të jenë të aksesueshme në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palë të treta të informuara nga KfW-ja (për shembull auditues) ose do t'i dërgohen, me kërkesë, KfW-së ose palëve të treta të informuara nga KfW-ja. Këto të dhëna dokumentuese përfshijnë fatura, dokumente dërgese, protokolle pranimi dhe të gjitha dokumentet përkatëse të nevojshme për të provuar pagesën.

3.8 Njoftimet për debinë do t'u shpërndahen automatikisht përfituesve të marrëveshjes së veçantë dhe palëve të tjera të përfshira, siç i janë komunikuar KfW-së nga pala e autorizuar.

Ju lutem, kontaktoni me zyrtarin e lartpërmendur të KfW-së, nëse keni pyetje rreth procedurës së disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca:

- A. Modeli i një shkrese që cakton nënshkruesit e autorizuar
- B. Kushtet plotësuese të KfW-së për disbursime sipas procedurës së fondit rezervë (duke përfshirë formularin për kërkesën për tërheqje)
- C. Termat e referencës për audituesit
- D. Formulari i tërheqjes për konsulentët në procedurën e drejtpërdrejtë të disbursimit
- E. Formulari i tërheqjes në procedurën e drejtpërdrejtë të thjeshtuar të disbursimit

SHTOJCA A

MODELI I NJË SHKRESE QË CAKTON NËNSHKRUESIT E AUTORIZUAR

Nga : _____

Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/projektit/ programi

Për:

KfW Bankengruppe

Në vëmendje të: L3a4

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së

2 milionë euro

Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore

Referenca e KfW-së, nr.2008 65 170, faza 1

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Duke iu referuar marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit për projektin/programin e lartpërmendur, do të dëshironim t'ju informojmë se çdokush prej personave, modeli i vërtetuar i nënshkrimit, të të cilit paraqitet në këtë shkresë, është i autorizuar të nënshkruajë kërkesën për tërheqje në emër të huamarrësit/përfituesit/agjencisë së zbatimit të programit/Projektit

- a) Emri:
Funksioni:
Modeli i nënshkrimit: _____
- b) Emri:
Funksioni:
Modeli i nënshkrimit: _____
- c) Emri:
Funksioni:
Modeli i nënshkrimit: _____

Të gjitha njoftimet e mëparshme (nëse ka) që kanë nënshkrimet e zyrtarëve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje sipas kësaj/huaje/kontributi financiar, anulohen.

Me respekt, _____
Firma e përfaqësuesit të autorizuar të marrëveshjes së huas/financimit/projektit/ programit
Datë _____

Shënim. Në rast se çdo kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një zyrtar, autorizimi duhet ta deklarojë këtë qartë. Nëse nënshkruerit e autorizuar janë ndarë në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i përbashkët, kjo, gjithashtu, duhet të deklarohet qartë.

SHTOJCA B
KUSHTET PLOTËSUESE TË KFW -SË
PËR PAGESAT SIPAS PROCEDURËS SË FONDIT REZERVË (KUSHTET PLOTËSUESE)

Kushtet e mëposhtme janë të zbatueshme për pagesat sipas procedurës së rënë dakord të fondit rezervë:

1. Pas marrëveshjes paraprake me KfW-në pala e autorizuar¹ do të kujdeset për hapjen e një llogarie të veçantë (llogaria e veçantë) me një bankë të njohur (banka përgjegjëse për llogarinë) që do të mbahet në emër të saj ose në emër të një pale të tretë të autorizuar nga pala e autorizuar dhe specifikisht, për të trajtuar:

a) shpenzimet në valutë:

me një bankë tregtare në Gjermani ose në ndonjë vend tjetër nga i cili duhet të bëhet shumica e prokurimeve.

b) shpenzimet në monedhën vendase:

me një bankë tregtare/bankë qendrore në vendin e palës së autorizuar. Në masën që është e mundur, kjo llogari duhet të mbahet si llogari në valutë të huaj në vendin e palës së autorizuar, me qëllim shmangien e humbjeve nga zhvlerësimi i monedhës dhe për të lejuar ritransferimin në çdo kohë; në raste të përshtatshme, shpenzimet në valutë të huaj mund të bëhen edhe nga kjo llogari.

Llogaria e veçantë duhet të mbahet ekskluzivisht për transaksionet e pagesave sipas fondit rezervë mbi një bazë kredie. KfW-ja ka të drejtën të marrë informacion në çdo kohë për këtë llogari.

2. Nëse nuk bihet dakord shprehimisht ndryshe, KfW-ja do të bëjë një depozitë fillestare me

¹ Përkufizim. Pala e autorizuar: huamarrësi, përfituesi/agjencia e zbatimit të projektit
Pala e tretë e autorizuar: për shembull, konsulenti

kërkesën e palës së autorizuar deri në një shumë që mbulon shpenzimet e planifikuara për katër muaj, në momentin që:

a) është njoftuar për emrin dhe vendin e bankës përgjegjëse për llogarinë e veçantë dhe të mbajtësit të llogarisë, si dhe për numrin e llogarisë dhe alokimin (projekt/program/masë, natyrën e llogarisë, për shembull, llogari besimi) të llogarisë së veçantë; dhe ka marrë një konfirmim të bankës përgjegjëse për llogarinë në formën e kërkuar nga KfW-ja (shihni aneksin nr.1);

b) është paraqitur një parashikim i shpenzimeve për periudhën përkatëse;

c) janë plotësuar të gjitha elementet e nevojshme të mbetura kontraktuale;

d) KfW-ja pret, gjithashtu, që fondet të përdoren pa vonesë.

Nëse mbajtësi i llogarisë është palë e tretë e autorizuar¹:

e) duhet të paraqitet edhe një deklaratë alokimi (shihni aneksin nr.2).

Në rast se pala e autorizuar aplikon për një rritje të depozitës fillestare (parapagim), paraqitet një parashikim i përditësuar i shpenzimeve, i shoqëruar me një kërkesë për tërheqje të nënshkruar rregullisht.

3. Pagesat mund të bëhen vetëm për qëllimin e rënë dakord dhe vetëm për masat e miratuara nga KfW-ja me shkrim (për shembull, mbi bazën e kontratave të lidhura të furnizimit dhe shërbimit, grafikëve të kostos dhe kohorë për realizimin e punimeve të kontraktuara të ndërtimit, listat e prokurimit të rëna dakord me KfW-në etj.).

4. KfW-ja do të plotësojë fondin rezervë, me kërkesë të palës së autorizuar/palës së tretë të autorizuar, brenda shumës maksimale të rënë dakord, sapo të ketë marrë brenda periudhës së rënë dakord dhe të pranuar të dhënat e duhura dokumentuese të shpenzimeve në formë të thjeshtuar (shihni aneksin nr.3, modelin e kërkesës për plotësim) dhe me paraqitjen e një parashikimi shpenzimesh të planifikuara për katër muajt e ardhshëm që është i pranueshëm për KfW-në. Taksat dhe tarifat e tjera publike që duhet të paguhet nga huamarrësi/përfituesi i projektit/agjencisë së zbatimit të programit, të kontributit financiar, si dhe taksat e importit dhe në rastin e punimeve të kontraktuara të ndërtimit shpenzimet e përgjithshme administrative të huamarrësit/përfituesit të projektit/agjencisë së zbatimit të programit të kontributit financiar, nuk mund të financohen.

5. Nëse nuk bihet dakord shprehimisht ndryshe, pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të mbajë të gjitha të dhënat origjinale dokumentuese të shpenzimeve që i korrespondojnë disbursimeve të bëra nëpërmjet fondit rezervë (duke përfshirë pasqyrat e llogarive, konfirmimet bankare të kurseve të këmbimit të aplikuara, garancitë bankare, çdo faturë tjetër bankare dhe çdo dokument tjetër që provon se mallrat dhe shërbimet janë dorëzuar dhe përmbushur siç duhet, pra faturat tregtare, dokumentet e dërgesës, vërtetimet e pagesës dhe të pranimit etj.) deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe do të jenë të aksesueshme në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të informuara nga KfW-ja (për shembull audituesit) ose do t'ia dërgojë ato, me kërkesë, KfW-së ose palëve të treta të informuara nga KfW-ja.

6. Pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të garantojë që pagesat fillestare të bëra të kompensohen ndaj mallrave të furnizuara/shërbimeve të dhëna dhe se do të shfrytëzohen zbritje të mundshme.

7. Çdo interes kredie do të përdoret për masat sipas pikës 3 më sipër.

8. Nëse shuma e disponueshme në fondin rezervë nuk nevojitet e plotë, në kundërshtim me planin (pra, shpenzimet për 4 muaj), pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të shlyejë me pëlqimin e vet dhe do të informojë KfW-në për çdo fond që nuk kërkohet, nëse nuk është arritur një marrëveshje për të kundërtën.

9. Pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar do të garantojë që të gjitha të dhënat dokumentuese të pranuar të shpenzimeve të jenë plotësisht në dispozicion të KfW-së brenda gjashtë muajve pas përfundimit të masave/përfundimit të projektit/programit ose pas disbursimit të plotë të fondeve të synuara për fondin rezervë.

Çdo shumë që nuk mund të provohet në nivel të mjaftueshëm, e cila është shpenzuar për qëllimin e rënë dakord, do t'i kompensohet KfW-së menjëherë nga pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar.

10. KfW-ja nuk është më e detyruar të plotësojë fondin rezervë dhe ka të drejtë të anulojë çdo kredi që është ende në fond, nëse ka të drejtë ndaj huamarrësit/përfituesit të huas/kontributit financiar për të pezulluar disbursimet sipas marrëveshjes së huas/financimit.

11. KfW-ja ka të drejtë në çdo kohë:

a) të zvogëlojë volumin e fondit rezervë; dhe

b) të kërkojë kompensimin e shumave që nuk janë provuar në nivel të mjaftueshëm se janë përdorur si duhet.

12. Të gjitha shlyerjet në favor të llogarisë përkatëse të marrëveshjes së huas/financimit/projektit/programit duhet të bëhen nëpërmjet Deutsche Bundesbank (MARKDEFF) për KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00 llogaria nr. 38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 38 000 000 00), duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Aneksi nr.1: Modeli për konfirmimin e bankës përgjegjëse për llogarinë, sipas pikës 2.a.

Aneksi nr.2: Modeli për deklaratën e alokimit, sipas pikës 2.e (e zbatueshme vetëm nëse llogaria e veçantë mbahet në emër të një pale të tretë të autorizuar)

Aneksi nr.3: Modeli për kërkesën për tërheqje për plotësim dhe paraqitja e të dhënave dokumentuese për përdorimin e fondeve.

SHTOJCA B

ANEKSI 1

Aneksi nr.1 i “Kushteve plotësuese” të KfW-së

Emri dhe adresa e bankës:

Konfirmimi i bankës përgjegjëse për llogarinë

KfW Bankengruppe

TM a

Palmengartenstrasse 5-9

60325 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së

2 milionë euro

Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore

Referenca e KfW-së nr.2008 65 170 Faza I

(Pala e autorizuar ose pala e tretë e autorizuar).....
na ka kërkuar me anë të shkresës së datës të hapë një llogari të veçantë që duhet të mbahet ekskluzivisht mbi bazë kredie për pagesat të cilat duhet të bëhen nga fondet e Bashkëpunimit Financiar Gjerman ose programe të ngjashme të KfW-së.

Rrjedhimisht, ne kemi hapur një llogari të veçantë nr. për pagesat nga huaja/kontributi financiar i mësipërm në emër të të mbajtur në monedhën e(kodi ISO).

Ne kemi marrë në konsideratë se llogaria e mësipërme do të financohet dhe plotësohet me fonde të posaçme nga huaja/kontributi financiar i mësipërm dhe kështu heqim dorë nga kërkimi i të drejtës sonë për kompensim dhe ruajtje, si dhe nga e drejta jonë për mbajtje peng në lidhje me këto balanca për të cilat jemi të autorizuar sipas kushteve tona të përgjithshme bankare ose për të cilat mund të jemi të autorizuar për arsye të tjera. Ne do t'ju informojmë pa vonesë për çdo rregullim të vendosur nga palët e treta dhe mbi llogarinë e veçantë të mësipërme.

Pala/ët/personat e autorizuar për të përdorur llogari është/janë

Ne nuk do të ndryshojmë autoritetin për të përdorur llogarinë e mësipërme, nëse dhe derisa të kemi marrë pëlqimin e KfW-së.

Ne autorizohemi nga mbajtësi i llogarisë/pala e autorizuar për të përdorur llogaritë, t'ju informojmë në çdo kohë për llogarinë dhe transaksionet e pagesës të kryera nëpërmjet llogarisë. mbajtësi i llogarisë/pala e autorizuar për të përdorur llogarinë, na ka informuar në mënyrë të paravokueshme për të transferuar balancat ekzistuese mbi llogarinë e mësipërme dhe mbi çdo nënlllogari të ngjashme, në bazë të kërkesës suaj fillestare. Transferimi duhet të bëhet nëpërmjet Deutsche Bundesbank (MARKDEFF) për KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00 llogaria nr. 38 000 000 00 (IBAN DE53 5002 0400 38 000 000 00), duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Ky konfirmim i bankës aplikohet njëlloj për çdo nënlllogari.

Datë

Vula dhe firma e detyrueshme e bankës përgjegjëse për llogarinë

SHTOJCA B
ANEKSI 2

Aneksi nr. 2 i “Kushteve plotësuese” të KfW-së

Emri dhe adresa e palës së tretë:.....

Deklarata e caktimit të palës së tretë të autorizuar nëse llogaria hapet
në emër të saj si llogari besimi

KfW Bankengruppe
TM a
Palmengartenstraße 5-9
60325 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së
2 milionë euro
Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore
Referenca e KfW-së nr.2008 65 170, Faza I

Emri i projektit/programit/masës:

Llogaria e veçantë nr.:/monedha.....

Banka përgjegjëse për llogarinë:

Në ne hapëm llogarinë nr në emrin tonë me
(emri i bankës përgjegjëse për llogarinë) në të cilën ju do të paraqisni pagesat në lidhje me zbatimin
e projektit/programit (përcaktimi i masës) të financuar nga ana juaj në
përputhje me procedurën e fondit rezervë të vendosur nga ju dhe për të cilën na keni njoftuar. Ne
do t'i përdorim këto fonde vetëm për pagesa për mallrat dhe shërbimet (përveç shërbimeve tona të
paguara) të synuara për projektin/programin e mësipërm.

Me anë të kësaj, ju transferojmë secilën dhe të gjitha balancat mbi llogarinë e lartpërmendur.

Kjo deklaratë aplikohet njëllor për çdo nënlllogari.

.....
Datë

.....
Firma e mbajtësit të llogarisë/palës së autorizuar
për të bërë tërheqje

.....
Konfirmimi i firmës nga banka përgjegjëse
për llogarinë

Nëse llogaria mbahet me një bankë në Gjermani në emër të një shtetasi, me qëllim shmangien e rrezikut të zbritjes së parapaguar të taksës së prodhimit të kapitalit, është e nevojshme që mbajtësi i llogarisë t'i provojë bankës gjatë hapjes së llogarisë, se ajo është një llogari besimi dhe se përfituesi i kësaj llogarie nuk ka as zyrën kryesore, as selinë në Gjermani.

SHTOJCA B ANEKSI 3

Aneksi nr. 3 i “Kushteve plotësuese” të KfW-së

..... Datë

Emri dhe adresa e palës/palës së tretë të autorizuar për të kërkuar furnizim

KfW Bankengruppe
Në vëmendje të: TM a
Palmengartenstraße 5-9
60325 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së
2 milionë euro
Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore
Referenca e KfW-së nr.2008 65 170 Faza I

Emri i projektit/programit/masës:

Llogaria e veçantë nr./monedha.....

Banka përgjegjëse për llogarinë:

Kërkesa për tërheqje nr:.....

Kërkesa për furnizim dhe paraqitja e të dhënave dokumentuese për përdorimin e fondeve sipas procedurës së fondit rezervë për periudhën e.....

I/e nderuar zotëri/zonjë,

Në pajtim me procedurën e rënë dakord të fondit rezervë, ju bashkëlidhim të dhëna dokumentuese mbi përdorimin e fondeve në formë të thjeshtuar që vërtetojnë përdorimin e euros/ndonjë monedhe tjetër.....kodi ISO. Këto të dhëna përbëhen nga:

1. Deklarata e pajtueshmërisë për llogarinë/të e veçantë/a, së bashku me deklaratat bankare të llogarisë për të gjithë periudhën përkatëse, nënaneksi nr.1.

2. Pasqyra e shpenzimeve për mallrat/shërbimet e ofruara mbi bazën e marrëveshjes së veçantë, aneksi “Kostoja totale dhe financimi”, rënë dakord me KfW-në për çdo lloj specifik të masës, nënaneksi nr 2.

Ne konfirmojmë se shpenzimet nga llogaria e veçantë dhe nënlllogaritë e saj janë bërë dhe argumentuar në përputhje me dispozitat për procedurën e fondit rezervë dhe nuk janë financuar nga burime të tjera. Të dhënat dokumentuese origjinale ruhen në zyrën tonë në dhe janë të disponueshme për inspektim në çdo kohë nga ana juaj ose nga ndonjë palë e tretë e autorizuar nga KfW-ja.

Ne kërkojmë plotësimin e llogarisë së veçantë të fondit rezervë

Nr.....të mbajtur në emër të.....
me.....bank (emri dhe vendi i bankës përgjegjëse për llogarinë *²) në shumën prej euro/monedhë tjetër(kodi ISO).....
.....

Nënshkrimi i palës/palës së tretë të autorizuar për të kërkuar plotësim

Nënaneksi nr.1: Deklarata e pajtueshmërisë

Nënaneksi nr.2: Pasqyra e shpenzimeve

SHTOJCA B NËNANEKSI 1 I ANEKSIT 3

Nënaneksi nr. 1 i kërkesës për tërheqje nr.....

KfW Ref. nr.:.....

Pajtueshmëria e llogarive të veçanta/ për periudhën e kontabilitetit nga

deri më

Llogaria e veçantë nr.....më(emri i bankës)

² Për më tepër, nëse banka e pagesit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të sigurohet emri dhe adresa e përfaqësuesit të bankës në atë vend.

| | | Euro |
|---------------------------|--|------|
| 1. | Balanca e llogarisë në fillim të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë) | |
| 2. | Shumat e kredituara | |
| | a) Shumat e marra nga KfW-ja | |
| | b) Interesi i kredisë | |
| Totali i kredituar | | |
| 3. | Shumat e debituar | |
| | a) Pagesat e kryera në periudhën aktuale sipas kolonës 4 të nënaneksit 2 (pasqyra e shpenzimeve - SOE) | |
| | b) Tarifat bankare | |
| | c) Transfertat në llogarinë e monedhës vendase (nëse është e mundur) | |
| Totali i debituar | | |
| 4. | Balanca e llogarisë në fund të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë) | |
| 5. | Shpenzimet e planifikuara për katër muajt e ardhshëm | |
| 6. | Shuma që duhet të plotësohet (5 minus 4) | |

Nëse është e zbatueshme, edhe për:

Llogarinë e veçantë lokale nr.....më(emri i bankës)

| | | Monedha vendase |
|---------------------------|--|--------------------|
| 1. | Balanca e llogarisë në fillim të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë) | |
| 2. | Shumat e kredituara | |
| | a) Transferta nga llogaria nr.....(llogaria e veçantë në euro) | |
| | b) Interesi i kredisë | |
| Totali i kredituar | | |
| 3. | Shumat e debituar | |
| | a) Pagesat e kryera në periudhën aktuale sipas kolonës 4 të nënaneksit 2 (pasqyra e shpenzimeve - SOE) | |
| | b) Tarifat bankare | |
| Totali i debituar | | |
| 4. | Balanca e llogarisë në fund të periudhës së kontabilitetit (sipas deklaratës së llogarisë) | |
| 5. | Shpenzimet e planifikuara për katër muajt e ardhshëm | |
| 6. | Shuma që duhet të plotësohet (5 minus 4) | |

Datë..... Firma.....pala e autorizuar/pala e tretë e autorizuar

SHTOJCA B
NËNANEKSI 2 I ANEKSIT 3

Nënaneksi 2 i kërkesës për tërheqje nr:.....(plotësimi) i datës.....
Pasqyra e shpenzimeve (SOE)

| | | |
|---|--|---|
| Referenca e KFW-së nr: | Emri i projektit/programit: | Periudha e kontabilitetit: Nga.....deri..... |
|---|--|---|

| Kolona 1* | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|--|---|---|---|-----------------------------------|---|
| E njëpasnjëshme nr. dhe përshkrimi i masave të veçanta | Shuma e masës (siç është rënë dakord) Monedha: | Shpenzimet në periudhën pararendëse të kontabilitetit Monedha: | Shpenzimet në periudhën aktuale të kontabilitetit Monedha: | Shpenzimet totale Monedha: | Që ende duhet të disbursohet (kolona 2 minus kolonën 5) Monedha: |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| TOTALI | | | | | |

Ne konfirmojmë se mallrat dhe shërbimet tashmë nuk janë financuar nga grantet ose huat afatgjata.

Datë.....

Datë.....

.....

Nënshkrimi i palës së autorizuar

Nëse është e zbatueshme Nënshkrimi i konsulentit

***Ju lutem renditni elementet sipas atyre të treguara në aneksin e marrëveshjes së veçantë “Kostoja totale dhe financimi”.**

SHTOJCA C
TERMAT E REFERENCËS: AUDITI I “FONDIT (EVE) REZERVË”

Objektivi

1. Objektivi i auditit të fondit (eve) rezervë, duke përfshirë llogarinë e veçantë të hapur me ... *ëmri i bankës*], është që të lejojë audituesin të shprehë një opinion në lidhje me raportet financiare (d.m.th. gjendja e llogarive dhe pasqyra e kumuluar e përcaktuar në aneksin “Procedura e disbursimit” e marrëveshjes së veçantë) dhe pasqyrat e shpenzimeve të bazuara në kërkesat për tërheqje për fond (et) rezervë. Këto shpenzime janë bërë sipas situatës financiare të huas/grantit të KfW-së nr. ... [*referenca e KfW-së nr.*] për financimin e ... *ë(pjesa e) emri i projektit/programit*].

2. Auditimi do të kryhet çdo vit (periudha e auditimit) dhe raporti (et) përkatës/e duhet të paraqiten jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar. Gjatë periudhës së auditimit disbursimet totale që arrijnë shumën prej ... janë transferuar në fondin (et) rezervë.

Qëllimi

3. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Standardet e Garancisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, me referencë të veçantë ndaj ISA 800 (Raporti i audituesve për angazhimet e auditit të posaçëm) dhe do të përfshijë ato teste dhe kontrolle që audituesi i çmon të nevojshme, si dhe vizitat në terren, nëse konsiderohet e nevojshme. Audituesi duhet të ketë parasysh se për përgatitjen e një opinionit auditimi, ai duhet të kryejë një auditim pajtueshmërie, dhe jo një auditim normal zyrtar.

Përgatitja e raporteve financiare dhe pasqyrave të shpenzimeve për faturat e parave dhe bazën e kontabilitetit të disbursimit është përgjegjësia e agjencisë së zbatimit të projektit. Informacioni financiar duhet të përgatitet në përputhje me standardet e aplikuara sipas rregullave të kontabilitetit dhe marrëveshjen kryesore të huas/financimit, duke përfshirë marrëveshjen korresponduese të veçantë.

Opinionit i audituesit, i përfshirë në raportin e opinionit të audituesit, do të deklarojë qartë nëse:

a) Pagesat nga fondi (et) rezervë janë bërë në përputhje me marrëveshjen (t) përkatëse (të huas/financimit) dhe marrëveshjen korresponduese të veçantë. Nëse identifikohen shpenzime të papërshtatshme, ato duhet të shënohen veçmas.

b) Fondi (et) rezervë duhet të mbahet/n në përputhje me dispozitat e marrëveshjes (së huas/financimit) dhe marrëveshjes së veçantë (përfshirë kushtet plotësuese të KfW-së për pagesat sipas procedurës së fondit rezervë). Kjo përbën, gjithashtu, interesin e përfutur nga balancat.

c) Shpenzimet mbështeten nga të dhëna të duhura dhe të besueshme. Të gjitha dokumentet dhe të dhënat mbështetëse në lidhje me pasqyrën e shpenzimeve të paraqitura si bazë për kërkesat për tërheqje janë vënë në dispozicion.

d) Pasqyrat e audituara të shpenzimeve mund të merren si bazë për argumentimin e kërkesave të ngjashme për tërheqje. Duhet të ekzistojë një lidhje e qartë midis pasqyrave të shpenzimeve, kërkesave për tërheqje të paraqitura KfW-së dhe të dhënave të kontabilitetit.

e) Mallrat dhe shërbimet e financuara janë prokuruar në përputhje me marrëveshjen përkatëse (të huas/financimit) dhe marrëveshjen e veçantë.

f) Janë identifikuar të meta dhe dobësi specifike në sistemet dhe kontrollet e brendshme të agjencisë së zbatimit të projektit. Nëse identifikohen të meta, ato duhet të shënohen veçmas.

Raportet

4. Raporti (et) e auditimit:

- a) do të lëshohen nga audituesi në gjuhën angleze;
- b) do të përfshijnë të gjitha aspektet e përcaktuara në paragrafin pararendës (fusha e veprimit);
- c) do të përmbajnë këta terma reference si pjesë përbërëse;
- d) do të sigurojnë një skedul që tregon faturat dhe disbursimet gjatë periudhës së auditimit;
- e) do të përfshijnë balancën e llogarisë (ve) të veçantë/a dhe të gjitha nënllogaritë (nëse ka) në fillim dhe në përfundim të periudhës së auditimit;
- f) do të përfshijnë deklaratat e audituesit për të vlerësuar dhe përcaktuar nivelin e pasojave të të metave specifike, nëse ka.

5. Nëse çmohet e nevojshme, audituesi do të përgatitë edhe një letër menaxhimi, në të cilën audituesi:

a) do të japë komente dhe vërejtje në lidhje me të dhënat e kontabilitetit, sistemet dhe kontrollet e shqyrtuara gjatë auditit (në masën që është e nevojshme për kuptimin e raporteve financiare dhe pasqyrave të shpenzimeve);

b) do të identifikojë të metat dhe dobësitë specifike në sistemet dhe kontrollet e agjencisë së zbatimit të projektit që duhet të sillen në vëmendjen e audituesit, veçanërisht në lidhje me tërheqjen, prokurimin, ruajtjen dhe transaksionet e pagesës dhe do të bëjë rekomandime për përmirësimin e tyre;

c) do të raportojë në lidhje me masat e marra nga personeli drejtues i agjencisë së zbatimit të projektit për të bërë përmirësime në lidhje me të metat dhe dobësitë e raportuara në të shkuarën;

d) do të sjellë në vëmendjen e agjencisë së zbatimit të projektit çdo çështje tjetër që audituesi e konsideron të përshtatshme.

SHTOJCA D

Nga:

(adresa e palës së autorizuar)

(datë)

KfW Bankengruppe
TM a
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së
2 milionë euro
Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore
Referenca e KfW-së nr.2008 65 170, Faza I

Lënda: Kërkesa për tërheqje nr.
Procedura e drejtpërdrejtë e disbursimit (konsulenti)

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave ju kemi dërguar, janë ofruar dhe duhet të paguhen shërbimet e mëposhtme:

| Zëri Nr.* | Kontrata e konsulencës datë me | Fatura e konsulentit nr. datë | Monedha/shuma) |
|--------------|--|--|----------------|
| | | | |

* Zëri "Lista e mallrave dhe shërbimeve"

SHTOJCA D

Sipas "Listës së mallrave dhe shërbimeve", shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme do të paguhën nga huaja/kontributi financiar që ne kemi kërkuar të disbursojmë, si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

Përfituesi (emri dhe adresa e firmës)

.....

Llogaria nr:.....IBAN (nëse është e zbatueshme)

Emri i bankës:.....Kodi BIC:

.....

Banka përfaqësuese:*.....Kodi BIC:

.....

Si provë mbështetëse është bashkëlidhur një kopje e faturës përkatëse, nëse është e mundur, së bashku me të dhëna dokumentuese të bazave të rëna dakord kontraktualisht për ngritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për artikujt e rimbursueshëm.

Mbetemi në pritje të njoftimeve tuaja mbi debinë për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

* Për më tepër, nëse banka e paguesit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të sigurohet emri dhe adresa e përfaqësuesit të bankës në atë vend. Kërkohen aplikime të veçanta për çdo monedhë të kërkuar.

SHTOJCA E

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(data)

KfW Bankengruppe
TM a
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huas/financimit/projektit/programit e KfW-së
2 milionë euro
Emri i projektit/programit: Menaxhimi i mbetjeve të ngurta për Shqipërinë Juglindore
Referenca e KfW-së nr.2008 65 170, faza I

Lënda:Kërkesa për tërheqje nr.
Procedura e drejtpërdrejtë e thjeshtuar e disbursimit

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave iu kemi dërguar, janë ofruar dhe duhet të paguhen mallrat/shërbimet e mëposhtme:

| Zëri nr.* | Kontrata për mallra/shërbime datë me | Fatura Nr. datë | Monedha/shuma) |
|------------------|---|-----------------------------------|-----------------------|
| | | | |

* Zëri "Lista e mallrave dhe shërbimeve"

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës së kërkueshme do të paguhën nga huaja/kontributi financiar që ne kërkojmë ta disbursoni, si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)

.....

Llogaria nr.....IBAN (nëse është e zbatueshme)

Emri i bankës:.....kodi BIC:.....

.....

Banka përfaqësuese:*).....kodi BIC:

.....

Si provë mbështetëse është bashkëlidhur një kopje e faturës përkatëse.

Me anë të kësaj, konsulenti deklaron se ka lëshuar një “vërtetim pagese”, që konfirmon se shërbimet dhe mallrat që faturohen, janë kryer realisht, pagesa është bërë e kërkueshme dhe të gjitha dokumentet e nevojshme janë paraqitur dhe janë në përputhje me rregulloret/standardet e KfW-së.

.....

(Firma e përfaqësuesit të konsulentit)

Mbetemi në pritje të njoftimeve tuaja mbi debinë për disbursimet e bëra nga ana juaj.

.....

(Firma e palës së autorizuar)

*) Për më tepër, nëse banka e paguesit nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të sigurohet emri dhe adresa e përfaqësuesit të bankës në atë vend. Aplikime të veçanta kërkojnë për çdo monedhë të kërkuar.

ANEKSI 8 PËRMBAJTJA DHE FORMA E RAPORTIMIT

a) Informacioni kryesor dhe sfondi i përgjithshëm i projektit

Agjencia për zbatimin e projektit (AZP) raporton (nëse është e mundur, me mbështetjen e një konsulenti) çdo gjashtë muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit (së pari në raportin e fundit tremujor 2010) dhe çdo vit nga një vit pas vënies në funksionim, mbi çështjet e mëposhtme.

Kur është e mundur, ju lutem tregoni zhvillimin me seri kohore statistikore. Shpjegoni çdo zhvillim specifik. Vlerësoni ndikimet e tyre në suksesin e qëndrueshëm të projektit.

1. A ka mbetur SHRMMK-ja një shoqëri e qëndrueshme?

- Pasqyrat financiare (për shembull: llogaria e fitimit dhe humbjeve, bilanci, pasqyrat financiare vjetore mundësisht të vërtetuara ose pasqyra e të ardhurave).

- A ka gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm? Zhvillimi i pagesave të aksionarëve.

- Zhvillimi dhe ndryshimet në lidhje me aksionarët e SHRMMK-së.

- A janë krijuar fusha të reja operimi që prej vlerësimit të projektit?

- Zhvillimi i personelit dhe ndryshimet (numri i personelit, përshkrimet e punës etj.).

- Të dhëna të mëtejshme në varësi të rastit specifik: në veçanti të dhëna në lidhje mbi tipin e projektit ose sektorin specifik (për shembull: shifra të shitjeve, shfrytëzimi i kapaciteteve, niveli i kompensimit të kostos, humbjet e shpërndarjes, kostoja e prodhimit, zhvillimi i tarifave, llogari të papaguara).

2. A janë zhvilluar si duhet kushtet e përgjithshme ekonomike dhe sektoriale, dhe të tregut?

- Roli i konkurrencës dhe i furnizuesve të shërbimeve në lidhje me projektet (shërbimet e ofruara nga shoqëritë kryesore ose private, cilësia, zhvillimi i çmimit, besueshmëria etj.).

- Të dhëna të mëtejshme në varësi të rastit specifik (të dhëna të ngjashme në lidhje me tipin e projektit ose sektorin specifik), për shembull zhvillimi i popullsisë rajonale, zhvillimi i kushteve sektoriale, përqindjes së tregut.

3. A kanë mbetur të pranueshme ndikimet mjedisore të projektit? (Ju lutem renditni ndikimet veçmas për zbatimin dhe funksionimin.)

- A ka pasur ndryshime në legjisllacionin mjedisor në lidhje me projektin?

- A janë dhënë aprovimet e kërkuara nga legjisllacioni mjedisor mbi baza të besueshme?

- A plotësohen standardet mjedisore të autorizimit, dokumentet e hollësishme të projektimit, koncepti operacional, plani dhe marrëveshjet e menaxhimit mjedisor (nëse janë të zbatueshme)?

- A ka pasur ankesa ose padi në lidhje me ndikimet mjedisore?

- A garantohen kontrollet e synuara?

- Cilat masa të tjera të mbrojtjes mjedisore janë planifikuar?

B. Gjendja e zbatimit dhe grafiku kohor

Agjencia e zbatimit të projektit (SHRMMK) raporton (nëse është e mundur, me mbështetjen e një konsulenti) çdo tre muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit, mbi çështjet e mëposhtme. PEA/konsulenti do të regjistrojë të gjitha masat e planifikuara të projektit dhe kontratat kryesore dhe do t'i përditësojë ato në çdo raport.

1. Cila është gjendja e zbatimit të projektit si e tillë dhe e aktiviteteve specifike të projektit? (Mund të jepen informacione të hollësishme në tabelat e bashkëlidhura me raportet.)

- Caktimi i konsulentit: lidhja e kontratës, afatet, tipi i shërbimit të ofruar, fuqia punëtore e punësuar në nivel vendor dhe mbështetës.

- Lidhja e kontratave për mallrat dhe shërbimet: afatet, marrëveshja për specifikimet, publikimi, rezultati dhe vlerësimi i ofertave, propozimi për lidhjen e kontratës, konsulenca mbi kontratat për mallrat dhe shërbimet.

- Furnizimi i mallrave dhe ofrimi i shërbimeve (të zberthyera sipas listës së komponentëve të projektit ose kontratave të furnizimit).

- Mallrat: tipi dhe volumi, afatet e dorëzimit, garancitë e dhëna, inspektimi përfundimtar nga prodhuesi, pranimi.

- Transportet: tipi dhe volumi, kohëzgjatja, sigurimi, ruajtja në sheshin e ndërtimit.
- Punimet e ndërtimit: tipi dhe volumi, makineritë e përdorura, fuqia punëtore e punësuar, pranimi i punimeve të ndërtimit.
- Punimet e instalimit: tipi dhe volumi, makineria e përdorur, fuqia punëtore e punësuar, personeli i furnizuesve.
- Udhëzimi për personelin: tipi dhe fusha e veprimit, numri, kualifikimi i personelit operacional, trajnimi i avancuar në ambientet e furnizuesit.
- Vënia në funksionim: pranimi përfundimtar, teste funksionimi, rezultatet operationale, korrigjime defektesh. Raste të garancisë (tipi dhe fusha e veprimit, pasojat).
- Aktivitete të tjera: studime paraprake, shpërblime/çmime, tipi dhe fusha e veprimit, afatet, personeli, materialet, trajnimi i jashtëm, pranimi.

2. A mund të vihet në funksionim projekti në kohën e synuar?

- Përditësimi i aneksit 2 (informacion i përgjithshëm mbi investimet) dhe 3 (grafiku kohor) i marrëveshjes së veçantë; krahasimi i përmbushjes së synimeve; arsyet për devijimet dhe masat për korrigjimin e tyre; vlerësimi i ndikimit të devijimeve në fillim të funksionimit; vlerësimi i efektivitetit të masave të synuara korrigjuese; pasojat financiare dhe zhvillimore.

3. A mund të përmbushë detyrat e saj organizata e projektit, në veçanti funksionet e saj koordinuese?

- Krahasimi i përmbushjes së synimeve të organizatës së projektit; arsyet për vlerësimin e devijimeve. Cilat masa korrigjuese, nëse ka, janë të nevojshme?

C. Kostoja totale dhe financimi

Agjencia e zbatimit të projektit (SHRMMK) raporton (nëse është e mundur, me mbështetjen e një konsulenti) çdo tre muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit, mbi çështjet e mëposhtme (Përditësimi i aneksit 4 të marrëveshjes së veçantë; krahasimi i përmbushjes së synimeve; arsyet për devijimet dhe masat korrigjuese, nëse nuk shpjegohen tashmë sipas pikës B; pasojat e devijimit mbi koston totale dhe financimin e projektit dhe realizueshmëria e tij tregtare).

1. A garantohet financimi i projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij?

2. Sa prej fondeve totale të projektit dhe të huas FC (në detaje) janë shfrytëzuar, argumentuar dhe disbursuar në fund të periudhës nën rishikim?

3. Në cilën shumë janë rritur fondet diferenciale të interesit dhe si janë përdorur ato?

D. Funksionimi dhe realizimi i projektit

Agjencia e zbatimit të projektit (SHRMMK) raporton (nëse është e mundur, me mbështetjen e një konsulenti) çdo tre muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit deri një vit pas fillimit të funksionimit, më pas çdo gjashtë muaj, mbi çështjet e mëposhtme (përditësimi i aneksit 1, qasja e kuadrit logjik e marrëveshjes së veçantë).

1. A përmbushen kushtet për arritjen e rezultatit (eve), objektivit (ave) të modulit dhe objektivit (ave) të programit?

- Krahasimi midis situatës aktuale dhe situatës fillestare përshkruhet në aneksin 1 në lidhje me kushtet. Arsyet për devijimet. Vlerësimi i pasojave të devijimeve për suksesin e qëndrueshëm të projektit. Cilat aktivitete duhet të kryhen që të përmbushen kushtet? Vlerësoni efektivitetin e tyre dhe efektet financiare.

2. A mund të arrihen rezultati (et), objektivi (at) e modulit dhe objektivi (at) e programit? Deri kur?

- Krahasimi midis situatës aktuale dhe situatës fillestare përshkruhet në aneksin 1 në lidhje me rezultatin (et) dhe objektivin (at). Arsyet për devijimet. Vlerësimi i pasojave të devijimeve për suksesin e qëndrueshëm të projektit. Cilat masa duhet të merren për arritjen e qëllimeve? Vlerësoni efektivitetin e tyre dhe efektet financiare.

3. A kanë filluar apo a mund të priten zhvillime që rrezikojnë suksesin e qëndrueshëm të projektit (përfshirë cilësinë e marrëdhënieve ndërmjet huamarrësit, PEA-ja nga njëra anë dhe grupit të synuar dhe çdo institucioni ose firmë bashkëpunues/e nga ana tjetër)?

- Merrni në konsideratë deklaratat e bëra sipas pikës (A).

4. A është bërë ndonjë aktivitet shtesë i nevojshëm që duhet të përfshihet në planprojekt? A rezulton ndonjë aktivitet i tepërt i planifikuar projekti?

- Deklaroni aktivitetet, duke shënuar informacion sa më të hollësishëm në lidhje me natyrën, përmbajtjen, kohëzgjatjen, fillimin/përfundimin, agjencinë përgjegjëse, mundësisht procedurën e prokurimit, koston dhe financimin.

E. Tabela e monitorimit të projektit

Tabela e mëposhtme në lidhje me monitorimin e treguesve, rreziqeve dhe rezultateve i bashkëlidhet çdo raporti tremujor. PEA/konsulenti janë të lirë ta ndryshojnë atë, nëse çmohet e nevojshme, dhe KfW-ja lejohet ta ndryshojë, nëse është e nevojshme, në lidhje me detyrimet e saj të raportimit.

| TABELA MONITOREUSE | | | | |
|---|---|-------------------|---|---------------------|
| Objektivi i përgjithshëm | | | | |
| | Kontributi ndaj përmirësimit të shëndetit publik, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe shmangies së ndotjes mjedisore | | | |
| Kushtet për arritjen e objektivit të përgjithshëm | | R | I | Vlerësimi si ai i @ |
| A | Fushatat e ndërgjegjësimit kontribuojnë në sensibilizimin e popullsisë për mbrojtjen mjedisore | m | m | |
| B | Financimi i mjaftueshëm do të sigurohet nga bashkitë, me qëllim që venddepozitimet e afërta ekzistuese të mos jenë të dëmshme për mjedisin | h | m | |
| Objektivi i projektit | | | | |
| | Implementimi i një sistemi të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në rajonin e Korçës që mbrojnë burimet natyrore dhe mjedisin, si dhe shëndetin e njerëzve | | | |
| Treguesit për objektivin e projektit | | Statusi si ai i @ | | |
| 1 | Bashkitë dhe komunat që marrin pjesë në Shoqatën e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Rajonin e Korçës, përfaqësojnë të paktën 70 % të popullsisë së rajonit | | | |
| 2 | Niveli i grumbullimit të hedhjeve në zonat urbane është të paktën 90% të mbetjeve totale | | | |
| 3 | Niveli i grumbullimit të hedhjeve në zonat rurale është të paktën 70% të mbetjeve totale | | | |
| 4 | Eliminimi i rregullt i 100% të mbetjeve të pariciklueshme në vendgroposje | | | |
| 5 | Mbulimi i koston operative prej 80% nga tarifat e hedhjeve | | | |
| Kushtet për arritjen e objektivit të projektit | | R | I | Vlerësimi si ai i @ |
| A | Bashkitë dhe komunat vazhdojnë bashkëpunimin me SHRMMK-në | h | m | |
| B | SHRMMK-ja punëson personel të kualifikuar | m | n | |
| C | Rritjet e tarifave pranohen politikisht | h | m | |
| Rezultati 1 | | | | |
| | Vendgroposje e mjaftueshme dhe kapacitetet logjistike garantojnë një eliminim hedhjesh të padëmshëm për mjedisin | | | |

| | | | | |
|---|--|-------------------|---|---------------------|
| Masat për rezultatin 1 | | Statusi si ai i @ | | |
| 1.1 | Ndërtimi i një vendgroposjeje të re në Maliq | | | |
| 1.2 | Ndërtimi i stacioneve të transferimit | | | |
| 1.3 | Dorëzimi i kontejnerëve dhe kamionët tërheqës | | | |
| 1.4 | Dorëzimi i pajisjeve të lëvizshme për funksionimin e vendgroposjes | | | |
| Rezultati 2 | | | | |
| | Bashkitë dhe komunat kanë përmirësuar grumbullimin dhe transportin e hedhjeve | | | |
| Masat për rezultatin 2 | | Statusi si ai i @ | | |
| 2.1 | Dorëzimi i kamionëve të grumbullimit | | | |
| 2.2 | Prokurimi i kontejnirëve | | | |
| Rezultati 3 | | | | |
| | Shoqata e Menaxhimit të Hedhjeve është trajnuar dhe pajisur siç duhet për të përmbushur funksionet e saj | | | |
| Masat për rezultatin 3 | | Statusi si ai i @ | | |
| 3.1 | Masat shoqëruese | | | |
| Rezultati 4 | | | | |
| | Venddepozitimet ekzistuese mbyllen sipas rregullave | | | |
| Masat për rezultatin 4 | | Statusi si ai i @ | | |
| 4.1 | Shërbimet e ndërtimit në venddepozitimet ekzistuese | | | |
| Masat e kërkuara për më shumë se një rezultat | | | | |
| 1 | Shërbimet e konsulencës së zbatimit | Statusi si ai i @ | | |
| Kushtet për arritjen e rezultateve | | R | I | Vlerësimi si ai i @ |
| A | Janë marrë lejet mjedisore dhe të ndërtimit | m | m | |
| B | Lokalizimi i vendgroposjes mbetet i padiskutuar | m | m | |
| Marrëveshjet e veçanta të zbatimit | | | | |
| 1 | Bashkitë dhe komunat që marrin pjesë në Shoqatën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve, Korçë, përfaqëson të paktën 70% të popullsisë së rajonit | Statusi si ai i @ | | |
| 2 | Para publikimit të tenderit për ndërtimin e vendgroposjes higjienike në fazën e zbatimit 2, do të merren lejet e ndërtimit për vendgroposjen e re në Maliq | Statusi si ai i @ | | |
| 3 | Para kontraktimit të shërbimeve të ndërtimit dhe para disbursimit të parë të fondeve të parashikuara për fazën e zbatimit 2, do të finalizohet procesi i shpronësimit të tokës | Statusi si ai i @ | | |
| Treguesit e grupit të synuar | | | | |
| 1 | Grupi i synuar: numri i përdoruesve (2 vjet pas zbatimit të projektit) | Statusi si ai i @ | | |
| 2 | % e të varfërve të grupit të synuar | | | |

VENDIM
Nr.91, datë 24.3.2011

**PËR CAKTIMIN E FONDEVE PUBLIKE QË DO T'U SHPËRNDAHEN SUBJEKTEVE
ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET VENDORE TË VITIT 2011**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 86 pikat 2 e 6 dhe 87 pika 1 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Sasia e fondeve publike që do t'u shpërndahen subjekteve zgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2011 është 65 milionë lekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.92, datë 24.3.2011

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR
HETIMIN E DREJTIMIT DHE VEPRIMTARISË SË ORGANEVE DREJTUESE DHE
SHËRBIMEVE TË KUVENDIT PËR PERIUdhËN SHTATOR 2005 - DHJETOR 2010
NGRITUR ME VENDIMIN NR.90, DATË 17.3.2011**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit dhe neneve 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Erjon Braçe zgjidhet kryetar i komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e drejtimit dhe veprimtarisë së organeve drejtuese dhe shërbimeve të Kuvendit për periudhën shtator 2005 - dhjetor 2010”, ngritur me vendimin nr.90, datë 17.3.2011.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.215, datë 23.2.2011

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË GJENDJES SË MJEDISIT NË SHQIPËRI,
PËR VITIN 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 69 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e “Raportit të gjendjes së mjedisit në Shqipëri, për vitin 2009”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.260, datë 6.4.2011

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 20.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Qendra e Publikimeve Zyrtare t’i realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen e letrës offset dhe letrës samua.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Qendra e Publikimeve Zyrtare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr.140, datë 13.4.2011

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE NË LARGËSI
MBI 100 KM, JASHTË QENDRËS SË PUNËS, TË PUNONJËSVE TË INSTITUCIONIT TË
PREFEKTIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 27-33 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për Prefektin”, si dhe të pikës V/2/a/i të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin drejtuesve të njësive shpenzuese të prefekturave e nënprefekturave, të kompetencës për miratimin e shërbimeve në largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, brenda buxhetit të miratuar për vitin përkatës.

2. Ngarkohen drejtuesit e njësive shpenzuese të prefekturave e nënprefekturave, me zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

Në mungesë dhe me autorizim
ZËVENDËSMINISTRI
Avenir Peka

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|----------|
| KODI CIVIL | 360 lekë |
| KODI I FAMILJES | 310 lekë |
| KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE | 90 lekë |
| KODI PENAL USHTARAK | 55 lekë |
| KODI I PUNËS | 140 lekë |
| KANONI I ZHURISË | 40 lekë |
| PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE | 328 lekë |
| PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË | |
| PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |
| PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË | 512 lekë |

Hyri në shtyp më 20.4.2011
Doli nga shtypi më 20.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë